



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISE KAVAJË  
KRYESIA

VENDIM

Nr. 4 datë 17/04/2025

“Për organizimin dhe njoftimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Kavajë  
Për 24 Prill 2025”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 93, datë 21.08.2020, neni 56, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 17/04/2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 24/04/2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
(*Abnet Hasbani*)

2 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
(*Bruna Toliti*)

3 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
(\_\_\_\_\_)

4 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
(\_\_\_\_\_)

Kryetari i Këshillit Bashkiak

RUDIN HYLIVIU

